



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

30.05.2016			
Nr. i shtetit	Nr. i shtetit	shkollë	shkollë
01-013/672		prilog	



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Vitina

Në bazë të nenit 12. paragrafi 12.2 shkronja d) lidhur me nenin 17 paragrafi 1 shkronja e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, nenit 6 dhe 24 të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit nr 03/L-025 dhe nenit 36.paragrafi 36.2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seance e mbajtur më 24.05.2016, aprovon këtë:

V E N D I M
PËR HARTIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT LOKAL NË MJEDIS

Neni 1.

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë APROVON iniciativën për hartimin e Planit për Veprim Lokal në Mjedis në Komunën e Vitisë. Ky Plan do të jetë në përputhje me Planin e Republikës së Kosovës për Mjedis.

Neni 2.

Kryetari i Komunës formon grupin punues për hartimin e Planit të Veprimit Lokal në Mjedis, në të cilin përveç zyrtarëve të Komunës do të përfshihen edhe përfaqësues nga ndërmarrjet për kryerjen e shërbimeve publike, përfaqësues të OJQ-ve dhe të komunitetit të biznesit.

Neni 3.

Kuvendi i Komunës me rastin e aprovimit të buxhetit të Komunës për vitet vijuese do të planifikoj mjete buxhetore në fondin për bashkëfinancim me donator për implementimin e Planit për Veprim Lokal në Mjedis për vitet vijuese.

Neni 4.

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Kryetari i Komunës së Vitisë.

Neni 5.

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në Veb faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Drejtorisë për Urbanizëm
2. Drejtorisë për Kadastër,
3. Drejtorisë për Shërbime Publike,
4. Drejtorisë për Inspektion
5. Drejtorisë për Financa
6. Shërbimit të Kuvendit dhe
7. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Pira

